

LIGJ
Nr.9290, date 7.10.2004

PER PRODUKTET E NDERTIMIT

Indryshuar me:

- *Ligjin nr. 9825, datë 01.11.2007*
- *Lgjin nr.10 327, datë 30.9.2010*
- *Ligjin nr.19/2013, datë14.02.2013*

Ne mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton kushtet e përdorimit të produkteve të ndërtimit, pranimin e miratimeve teknike për këto produkte, vlerësimin dhe vërtetimin e konformitetit me kërkesat themelore, si dhe rregullon hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit, kryerjen e mbikëqyrjes së tregut dhe zbatimin e procedurave të veçanta për njohjen e tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për ato produkte ndërtimi që plotësojnë kërkesat themelore, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, dhe nuk zbatohet për produktet që nuk plotësojnë specifikimet teknike që u referohen neneve 5, 6 e 7 të këtij ligji.

KREU II
PERKUFIZIMET DHE KERKESAT THEMELORE TE PRODUKTIT TE NDERTIMIT

Neni 3
Përkufizime

Ne kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. "**Produkt ndërtimi**" është çdo produkt, i prodhuar për t'u përdorur, në mënyrë të përhershme, në punimet e ndërtimit.
2. "**Punime ndërtimi**" janë punimet e ndërtimit në ndërtesa, në objekte publike, në vepra

industriale, te infrastrukturës dhe ne objekte te tjera.

3. "**Hedhja ne treg**" është një produkt ndërtimi i përshtatshëm për përdorim ne Republikën e Shqipërisë.

4. "**Specifikime teknike**" janë standardet, miratimet teknike dhe rregullat teknike shqiptare, sipas neneve 5, 6 e 7 te këtij ligji.

5. "**Standard shqiptar**" është standardi i miratuar nga organizmi shqiptar i standardizimit.

6. "**Standard i harmonizuar**" është standardi i miratuar nga Organizata Evropiane e Standardizimit dhe i botuar ne "Gazetën zyrtare" te Komunitetit Evropian.

7. "**Miratim teknik shqiptar**" është miratimi teknik i një produkti ndërtimi, i dhënë nga organi miratues përkatës shqiptar.

8. "**Organ miratues**" është organi përgjegjës qe jep miratimet teknike shqiptare.

9. "**Ministër**" është ministri qe mbulon fushën e ndërtimit dhe te prodhimit te materialeve te ndërtimit.

10. "**Produkt i vogël ndërtimi**" është një produkt ndërtimi, i cili luan një rol te vogël ne raport me shëndetin dhe sigurinë.

11. "**Rregull teknologjik i pranuar**" është dispozita teknike, e cila, sipas eksperteve, reflekton gjendjen e teknologjisë.

12. "**Organ certifikimi**" është organi qe vërteton konformitetin e produkteve te ndërtimit ose te një sistemi, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit.

13. "**Organ inspektimi**" është organi qe vlerëson dhe rekomandon metodat e kontrollit te cilësisë e te seleksionimit te produkteve te ndërtimit, te prodhuara dhe te përdorura nga prodhuesi.

14. "**Laborator testimi**" është organi qe mat, ekzaminon, teston, kalibron ose përcakton karakteristikat apo cilësinë e materialeve a te produkteve te ndërtimit.

15. "**Vlerësim konformiteti**" është çdo veprimtari, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, qe përcakton nëse është plotësuar tërësia e kërkesave teknike te dokumentacionit përkatës.

16. "**Vërtetim konformiteti**" është pranimi paraprak i përputhshmërisë se produktit me kërkesat teknike.

17. "**Inspektim**" është çdo lloj forme kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, i kryer në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë

Neni 4

Kërkesat themelore

Kërkesat themelore te punimeve te ndërtimit, te cilat përcaktohen ne rregulloret përkatëse e qe duhet te plotësohen nga produktet, duke ruajtur karakteristikat kryesore, janë:

- a) rezistenca dhe qëndrueshmëria. mekanike;
- b) siguria ne rast zjarri;
- c) higjiena, shëndeti dhe mjedisi;
- ç) siguria ne përdorim;
- d) mbrojtja nga zhurmat;
- dh) kursimi i energjisë dhe ruajtja e ngrohtësisë.

KREU III

HEDHJA NE TREG E PRODUKTIT TE NDERTIMIT

Neni 5

Hedhja ne treg

Produkti i ndërtimit hidhet ne treg kur është i përshtatshëm për përdorimin e synuar dhe përmbush kërkesat themelore, te përcaktuara ne nenin 4 te këtij ligji.

Neni 6

Standardet e adaptuara

Produkti është i përshtatshëm kur plotëson karakteristikat kryesore për përdorimin e synuar dhe hidhet ne treg kur është ne përputhje me standardet shqiptare te harmonizuara, te adoptuara nga standardet përkatëse evropiane.

Neni 7

Standardet shqiptare

Kur nuk ekzistojnë standardet shqiptare, te përcaktuara ne nenin 6 te këtij ligji, produkti i ndërtimit hidhet ne treg nëse është ne konformitet me:

- a) standardet shqiptare;
- b) rregullat teknike shqiptare;
- c) miratimet teknike shqiptare, ne përputhje me nenet 11, 12 dhe 13 te këtij ligji.

Neni 8

Vlerësimi i konformitetit

Kur produkti i ndërtimit nuk i plotëson, tërësisht ose pjesërisht, kërkesat e nenit 6 apo te nenit 7, hidhet ne treg vetëm nëse prodhuesi zbaton procedurat e vlerësimit te konformitetit, te përcaktuara ne piken 1 te nenit 17 te këtij ligji. Ne këtë rast, deklarimi i konformitetit bazohet ne testin fillestar te produktit, te kryer nga një laborator i miratuar testimi.

Neni 9

Hedhja ne treg e produktit te vogël

1. Një produkt i vogël ndërtimi hidhet ne treg pas deklarimit me shkrim te prodhuesit se ka zbatuar rregullin teknologjik te pranuar.
2. Deklarimi i prodhuesit është i vlefshëm kur produkti plotëson kriteret e përcaktuara nga standardet shqiptare për konformitetin.

Neni 10

Kërkesa e konformitetit

Ministri kërkon vlerësimin e konformitetit te produktit te ndërtimit për vendosjen e markës se konformitetit, me ane te se cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i tij konfirmon, para se produkti te hidhet ne treg, se ky produkt është prodhuar ne përputhje me standardet.

KREUIV

MIRATIMI TEKNIK DHE ORGANI MIRATUES

Neni 11

Miratimi teknik

1. Miratimi teknik shqiptar i produktit te ndërtimit jepet nga organi miratues, i cili vërteton se ky produkt është i përshtatshëm për përdorimin e synuar. Miratimi teknik jepet për një periudhë 5-vjeçare, me te drejte rizgjatjeje edhe për 5 vjet te tjera.
2. Miratimi teknik shqiptar për një produkt ndërtimi mbështetet ne ekzaminimet, provat dhe vlerësimet, sipas kërkesave themelore për punimet e ndërtimit.
3. Miratimi teknik shqiptar i jepet një produkti ndërtimi te veçante vetëm nga një organ miratues, i autorizuar nga ministri.

Neni 12

Kritere për miratimin teknik

1. Organi miratues jep miratimin teknik shqiptar vetëm për një produkt ndërtimi, kur:
 - a) nuk ka as standard shqiptar dhe as rregull teknik shqiptar, sipas nenit 7 te këtij ligji;
 - b) ndryshon dukshëm nga një standard shqiptar ose rregull teknik shqiptar.
2. Për rishikimin e një miratimi teknik shqiptar zbatohen te njëjtat rregulla si për dhënien e tij. Kërkesa për miratim mund te paraqitet po tek ai organ miratues, qe ka dhënë miratimin e pare.
3. Miratimi teknik shqiptar i dhënë anulohet nëse organi miratues vihet ne dijeni nga organet e kontrollit se produkti i ndërtimit nuk është me i përshtatshëm për përdorimin e synuar dhe se nuk plotëson standardet shqiptare te përcaktuara ne nenin 7 te këtij ligji.

Neni 13

Kërkesa për miratimin teknik

1. Kërkesa për miratimin teknik shqiptar te produktit te ndërtimit mund te behet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, por pasi te këtë deklaruar se nuk ka bere një kërkesë te njëjtë ne organe te tjera miratuese.
2. Kërkesa e prodhuesit përmban përshkrimin e produktit te ndërtimit, specifikimet, projektet dhe rezultatet e provave, qe përcaktojnë produktin dhe përdorimin e tij te synuar, si dhe vendet ku ai do te shpërndahet.
3. Prodhuesi, para se te beje kërkesën për miratim, ka te drejte te kërkojë nga organi miratues te dhëna për:
 - a) procedurën e dhënies se miratimit teknik shqiptar;
 - b) përfundimin e afatit për realizimin e procedurës;
 - c) koston dhe mënyrën e pagesës.
4. Ministri përcakton kriteret për procedural e dhënies, te zgjatjes, te rishikimit dhe te anulimit te miratimit teknik shqiptar.
5. Organi miratues, kur e shet te nevojshme, i kërkon prodhuesit ose përfaqësuesit te tij dokumente shtese, rezultate te reja provash, llogaritje ose te dhëna te tjera, për te bere te mundur vlerësimin e produktit. Organi miratues garanton ruajtjen e sekretit për te gjitha te dhënat e marra gjate procedurës.

KREU V

VLERESIMI E VERTETIMI I KONFORMITETIT ME KERKESAT E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Neni 14

Vërtetimi i konformitetit

1. Prodhuesi është përgjegjës për vërtetimin e konformitetit të një produkti ndërtimi me kërkesat teknike. Para vërtetimit të konformitetit, përdorimi i tij do të përcaktohet nga provat, kontrolli ose metoda të tjera të vlerësimit të konformitetit. Procedurat e vlerësimit dhe të vërtetimit të konformitetit, në përputhje me specifikimet teknike, kryhen sipas nenit 12 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore.

2. Organet e caktuara për vërtetimin e konformitetit caktohen sipas nenit 14 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore

Neni 15

Metodat e kontrollit të konformitetit

1. Për vërtetimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, në përputhje me specifikimet teknike, përdoren metodat e mëposhtme:

- a) kontrolli fillestar i fabrikës dhe kontrolli fillestar i prodhimit në fabrike nga një ekip i miratuar;
- b) vënia në provë kontrolli e mostrave të marra në fabrike, në përputhje me një provë të paracaktuar nga prodhuesi ose ekipi i miratuar;
- c) vënia në provë e mostrave të marra nga një sasi e përgatitur për lëvrim, në tregun e hapur ose në një objekt, nga prodhuesi ose ekipi i miratuar;
- ç) mbikëqyrja, gjykimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i kontrollit të prodhimit në fabrike nga një ekip i miratuar.

2. Kontrolli i prodhimit në fabrike, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një kontroll i përhershëm, i brendshëm i prodhimit nga prodhuesi. Të gjitha elementet, kërkesat dhe mënyrat e përdorura nga prodhuesi për kontrollin e prodhimit në fabrike, dokumentohen, në mënyrë sistematike, në formën e politikave dhe të procedurave të shkruara.

3. Metodatat e përdorura për vërtetimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, sipas pikës 1 të këtij neni, varen nga kërkesat teknike për produktin ose për familje të veçanta të produkteve të ndërtimit.

Neni 16

Kriteret e vërtetimit të konformitetit

1. Vërtetimi i konformitetit të produktit të ndërtimit nënkupton që:

- a) prodhuesi i një produkti ndërtimi ka një sistem kontrolli të prodhimit në fabrike, prej të cilit sigurohet se prodhimi është në konformitet me specifikimet teknike;
- b) përveç sistemit të kontrollit në fabrike, për një produkt të veçantë ndërtimi, të përcaktuar në specifikimet përkatëse teknike, është miratuar një organ certifikimi për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e kontrollit të prodhimit ose të vetë produktit.

2. Përcaktimi i procedurave, sipas pikës 1 të këtij neni, varet nga:

- a) lloji i produktit te ndërtimit;
- b) rëndësia e produktit, ne raport me kërkesat themelore për punimet e ndërtimit;
- c) rezultatet e ndryshme te karakteristikave te produktit për qëndrueshmërinë e tij;
- ç) ndjeshmëria ndaj defekteve gjate prodhimit.

Neni 17

Procedurat e vlerësimit te konformitetit

1. Procedurat e vlerësimit te konformitetit te produktit mbështeten:

- a) ne deklaraten e konformitetit, te bere nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij;
- b) ne certifikatën e konformitetit për sistemin e kontrollit dhe te mbikëqyrjes se prodhimit ose për produktin, te lëshuar nga një organ certifikimi.

2. Nëse një organ certifikimi lëshon certifikatën e konformitetit për sistemin e kontrollit dhe te mbikëqyrjes se prodhimit, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij bën një deklaratë konformiteti për produktin e ndërtimit, ne mbështetje te kësaj certifikate.

3. Për një prodhim te veçante (ose jashtë serie), deklarata e konformitetit bazohet ne vënien ne prove te mostrës se produktit te ndërtimit dhe ne kontrollin e këtij produkti ne fabrike.

Neni 18

Marka e konformitetit

1. Pasi është shpallur dokumenti i konformitetit, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij vendos markën e konformitetit te produkti i ndërtimit.

2. Nuk mund te vendoset një marke konformiteti ose shenje tjetër, e ngjashme me te, qe mund te krijojë përshtjellim ne treg ose mashtrim te konsumatorit, te një produkt ndërtimi, qe nuk është i përshtatshëm për përdorimin e synuar ose për te cilin marka e konformitetit nuk është miratuar.

Neni 19

Përgjegjësitë e organit te certifikimit

1. Prodhuesi i materialeve te ndërtimit mund te angazhojë një organ certifikimi ne procedurat e vlerësimit te konformitetit vetëm nëse ky organ ka autorizim, qe vërteton aftësinë dhe përgjegjësinë e nevojshme për kryerjen e certifikimit te konformitetit, me rregullat dhe procedurat e caktuara. Produktet, te cilat janë brenda përgjegjësisë se organit te certifikimit, cilësohen ne autorizim.

2. Detyrat e përcaktuara ne piken 1 te këtij neni kryhen nga organi i certifikimit, i cili mund t'ia caktojë një ose me shume nga këto detyra edhe organeve te inspektimit ose laboratorëve te testimit.

KREU VI

MBIKEQYRJA E TREGUT

Neni 20

Organi i inspektimit te produktit

1. Organi i inspektimit për përmbushjen e kërkesave të këtij ligji dhe të akteve të data në zbatim të tij, për produktet e ndërtimit që hidhen në treg, është Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

2. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, përveç zbatimit të masave që rrjedhin prej akteve të veçanta, ushtron edhe këto përgjegjësi:

a) kërkon nga furnizuesi të paraqesë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentet e data për konformitetin, për produktet e ndërtimit;

b) kryen ekzaminimet e nevojshme dhe provat për produktet e ndërtimit, në përputhje me konformitetin, sipas specifikimeve teknike;

c) merr mostra të produkteve të ndërtimit për testim;

ç) urdhëron tërheqjen e dokumenteve të konformitetit në rastin e moskonformitetit të produkteve të ndërtimit;

d) ndalon hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit në rast moskonformiteti;

dh) ndalon përkohësisht, deri në kryerjen e ekzaminimeve ose të provave, çdo furnizim, oferte ose ekspozim të produkteve të ndërtimit, kur dyshohet se këto produkte nuk janë në përputhje me rregullat;

e) urdhëron zhdukjen e produkteve të ndërtimit në rast moskonformiteti kur ky është thelbësor për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së njerëzve.

3. Masat e parashikuara në shkronjat "ç", "d", "dh" dhe "e" të këtij neni janë masa urgjente dhe mund të vendosen krahas masave urgjente që parashikon ligji për inspektimin.

Neni 21

Përballimi i kostove të procedurave të inspektimit

1. Kostot e procedurave të inspektimit, kostot e analizave, të shpenzimeve ditore, udhëtimeve dhe të shpenzimeve të tjera, të bëra për procedurat e paraqitura, përballohen nga vete personi, kur ato janë në disfavor të tij.

2. Ankimi kundër vendimeve të marra, në përputhje me pikën 2 të nenit 20, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin dhe nuk e pezullon zbatimin e tyre.

Neni 22

Procedura të veçanta

1. *(e shfuqizuar)*

2. Njoha e deklarimeve dhe e miratimeve të sistemeve të huaja bëhet në përputhje me nenin 15 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësoret dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore.

KREU VII

SANKSIONET DHE MOSMARREVESHJET

Neni 23

Sanksionet

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbejnë veprë penale, përbejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) personi juridik gjobitet me 100000 deri në 1 000000 leke kur:

- i) hedh ne treg një produkt ndërtimi ne kundërshtim me nenet 5, 6, 7 e 8 te këtij ligji;
 - ii) bën një deklaratë për pranimin e produktit te ndërtimit ne kundërshtim me nenin 9 te këtij ligji;
 - iii) jep një miratim teknik shqiptar ne kundërshtim me nenet 11, 12 dhe 13 te këtij ligji;
 - iv) nuk vendos markën e konformitetit ne produktin e ndërtimit, ne përputhje me piken 1 te nenit 18 te këtij ligji;
 - v) ne kundërshtim me piken 2 te nenit 18, vendos ne produktin e ndërtimit një marke konformiteti ose çdo marke tjetër, te ngjashme me një marke tjetër ekzistuese, qe krijon pështjellim ne treg ose mashtron konsumatorin;
 - vi) miraton një organ certifikimi për vërtetimin e konformitetit ne kundërshtim me nenin 19 te këtij ligji;
 - vii) ne kundërshtim me nenin 20 te këtij ligji, nuk vepron ne përputhje me vendimet e strukturave përkatëse;
 - viii) vendos pezullimin e veprimtarisë deri në shlyerjen e detyrimit nga subjekti fizik dhe juridik;
 - ix) vendos sekuestrimin e mjeteve dhe të makinerive, të cilat punojnë gjatë kohës që subjekti është i pezulluar.
- b) personi fizik gjobitet me 50 000 deri ne 500 000 leke për te njëjtat kundërvajtje te përmendura ne shkronjën "a" te këtij neni.
- 2.** Gjobat vendosen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe janë dënim administrativ kryesor.
- 3.** Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit me gjobë bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet për procedurat e vlerësimit të konformitetit zgjidhen në përputhje me nenet 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore"

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 25

Nxjerrja e akteve nënligjore

- 1.** Ngarkohet Këshilli i Ministrave te nxjerre aktet nënligjore ne zbatim te neneve 4 e 7 te këtij ligji.
- 2.** Ngarkohet ministri, qe mbulon fushën e ndërtimit dhe te prodhimit te produkteve te ndërtimit, te nxjerre aktet nënligjore ne zbatim te neneve 19 e 26 te këtij ligji. Këshilli i Ministrave miraton formularët përkatës, që dokumentojnë procedurat e zbatuara nga INUK-ja, sipas përcaktimeve të bëra në nënpikat "viii" dhe "ix" të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji.

Neni 26

Dispozite kalimtare

Derisa te miratohen aktet nënligjore ne zbatim te këtij ligji, zbatohen ligji dhe aktet nënligjore ne fuqi.

Neni 27
Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4377, date 7.10.2004 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë,
Alfred Moisiu**